



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**

Tiranë, më 05/06/2026

**REAGIM PËR MEDIA**

Në lidhje me lajmin e publikuar nëpër media, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural sqaron se pretendimi se shtetasi Violand Braçellari ka përfituar fonde publike nga AZHBR për ngritjen e një ferme bagëtish është i pavërtetë. Shtetasi Violand Braçellari nuk ka aplikuar asnjëherë dhe nuk ka përfituar asnjë mbështetje financiare nga AZHBR.

Gjithashtu, është i pavërtetë pretendimi se stallat e janë ndërtuar me fonde të AZHBR-së. Ndërtimi i tyre nuk është financuar nga AZHBR dhe nuk ka qenë objekt i skemave të mbështetjes të administruara nga institucioni.

AZHBR thekson se familjarët e tij kanë përfituar mbështetje vetëm në kuadër të skemave kombëtare direkte të mbështetjes për aktivitetin bujqësor dhe blegtoral, në përputhje me kriteret dhe procedurat në fuqi. Përfitimi i mbështetjes financiare bazohet në ushtrimin e aktivitetit bujqësor ose blegtoral të certifikuar nga institucionet përgjegjëse, si dhe në verifikimin e të dhënave në databazat shtetërore.

Për transparencë të plotë, lista e përfituesve të skemave kombëtare dhe programeve të mbështetjes publikohet rregullisht dhe është e aksesueshme për publikun në faqen zyrtare të AZHBR-së, ku çdo i interesuar mund të verifikojë të dhënat përkatëse.